



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 866 prot.

Tiranë, më 06.06 2024

Vendim nr. 60, datë 06.06.2024

Mbi mandatet e anëtarëve të Kryesisë së Akademisë së Shkencave

Referuar pikës 4 të nenit 11, pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr. 53/2019 “për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 20, 21, 22 të Statutit mbi vlefshmërinë e mandateve të anëtarëve të Kryesisë së Akademisë e Shkencave të Shqipërisë, mbështetur informacionit të specialistit të burimeve nyrëzore dhe jurist (bashkëlidhur), Kryesia në mbledhjen e saj të datës 6.6.2024:

Vendosi:

1. Të zhvillohen zgjedhjet në fundvit për të tre pozicionet e anëtarëve të kryesisë me mandat 5 vjeçar, për sekretarin shkencor (të cilit i mbaron mandati në fund të vitit, në muajin dhjetor), kryetarin e sekretarin e Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike (të cilit i ka mbaruar mandati në muajin maj) dhe kryetarin e Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (një vit para afatit të mbarimit të mandatit);
2. Kryetari i Seksionit të Shkencave Natyrore e Teknike, akad. Neki Frashëri, komandohet të vazhdojë detyrën deri në zgjedhje;
3. Kryesia mirëkupton që kryetari i Seksionit të Shkencave Shoqërore e Albanologjike, akad. asoc. Gëzim Hoxha ofron dorëheqjen një vit para mbarimit të afatit në funksion të sikronizimit të zgjedhjeve për anëtarët e Kryesisë me mandat pesëvjeçar dhe vazhdon detyrën deri në zgjedhje;

4. Zgjedhjet do të zhvillohen sipas nenit 8, pika 2 të Ligjit 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fund të vitit, në periudhën 15 tetor – 15 nëntor 2024;
5. Data e zgjedhjeve do të njoftohet në shtator, pas këshillimit me Asamblenë;
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akad. Skënder GJINUSHI

KRYETAR

